



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1719/3 prot

Datë 23.09.2021

V E N D I M
K.P.P. 668/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.09.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Montal” SHPK, nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit me Nr. REF-04480-09-02-2021, Loti 8 me objekt “Sistemi i monitorimit fiziologjik dhe i telemetrisë së pacientit” me fond limit 8,355,926.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 05.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë

Ankimues: “Montal” SHPK
Rruga “Dervish Hima”, -3 Kullat, K3, A9/2, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 24 e vijues Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.09.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit me Nr. REF-04480-09-02-2021, Loti 8, me objekt “Sistemi i monitorimit fiziologjik dhe i telemetrisë së pacientit” me fond limit 8,355,926.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 13.09.2021 operatori ekonomik “Montal ” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Brenda afatit 5 ditor autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të.

II.5. Njëpërmjet shkresës me nr.2338/13 prot., datë 21.09.2021 protokolluar me tonën me nr.1719/2 prot., datë 21.09.2021 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik përgjigjia që autoriteti kontraktor i ka kthyer operatorit ekonomik ankimes në lidhje me ankesën e tij të datës 13.09.2021 për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.6. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes dhe me shkresën nr. nr.2338/13 prot., datë 21.09.2021 ka vënë në dijeni operatorin ekonomik ankimes dhe Komisionin e Prokurimit Publik se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Operatori ekonomik ankimes në ankesën e tij ka ankimuar specifikimet teknike për:

- **Artikullin nr.1- sistem monitorimi pacienti me telemetri** në lidhje me: **1.** *Kjo do të jetë për të mbledhur dhe shfaqur parametrat në stacionin qendror dhe për të bërë në dispozicion të EMR. Kjo ndërfaqe të jetë e disponueshme në departamentet 6S, 5W & 5E*. -për të cilin ka kërkuar – *Të specifikoni monitorët ekzistues të shenjave vitale. Të specifikoni çfarë është “EMR”, dhe çfarë janë departamentet 6S, 5W & 5E. Në të kundërt ky specifikim të hiqet sepse krijon paqartësi për operatorët ekonomik.* **2.** *PPMTS do të përfshijë një metodë për të mbledhur, vlerësuar dhe menaxhuar klinikën e rasteve të alarmit në përputhje me Qëllimin Kombëtar të Sigurisë së Pacientit NPSG.06.01.01 - për të cilin ka kërkuar- Të specifikoni çfarë është PPTMS dhe NPSG.06.01.01.Në të kundërt të hiqet sepse krijon paqartësi për operatoret ekonomik;* **3.** *Pajisja CS duhet të sigurojë tiparet dhe funksionalitetin e mëposhtëm: b Të paktën zgjedhja e përdoruesit 6 parametra për pacient- për të cilin ka kërkuar modifikimin e tij në- Të mundësohet zgjidhja nga përdoruesit për të paktën 4-6 parametra monitorimi për pacient. ;* **4.** *Numri i pacientëve të shfaqur në stacionin qendror do të jetë njësi specifike me deri në 16 pamje të njëkohshme në ekranin e vetëm - për të cilin ka kërkuar modifikimin e tij në- Numri i pacientëve (monitorëve të pacientit) të shfaqur në stacionin qendror do të jetë deri në 16 pamje (paciente) të njëkohshme.;* **5.** *Lejoni të gjitha paketat e telemetrisë dhe / ose monitorët e pacientit të lidhur në rrjet fushat e kujdesit që do të shikohen në CS dhe në çdo sistem të klientit CS të rrjetëzuar me CS.*

a Në rrjet për të lejuar shikimin e pacientëve në njësi të tjera nga çdo qendër stacioni.- për të cilin ka kërkuar – Të përcaktoni numrin e monitorëve të pacientit që kërkohen të lidhen me sistemin e monitorimit.

-**Artikullin nr.2-Monitori pranë shtratit Lloji A: Monitorët e dhomës operative** në lidhje me: **1.** *Moduli SpO2 - i pajtueshëm me teknologjinë Nellcor Oximax- për të cilin ka kërkuar- Moduli SpO2 - i pajtueshëm me teknologjinë Nellcor Oximax ose teknologji ekuivalente;* **2.** *Moduli i indeksit bi-spektral (BIS)- për të cilin ka kërkuar modifikimin e tij në- Moduli i indeksit bi-spektral (BIS) ose ekuivalente.*

- **Artikullin nr.8 Kabllimi/rrjeti** në lidhje me: **1.** *Sistemi Shëndetësor do të sigurojë një lidhje të vetme të rrjetit CAT6a për secilin monitor pranë shtratit dhe stacionit qendror. Kontraktuesi do të sigurojë PPMTS me kërkesat e mëposhtme duke përdorur rrjeti ekzistues kur plotëson specifikimet – për të cilin ka kërkuar- Të përcaktoni për cilat tipe monitorësh (numra artikujsh të lotit) kërkohet që të sigurohet rrejtja për t’u lidhur me stacionin qendror të monitorimit. Specifikoni çfarë është PPMTS dhe çfarë kërkohet konkretisht nga operatorët;* **2.** *Të gjitha linjat e kabllave mbi tavan duhet të mbështillen me kravatë dhe të vendosen në sirtarin e kabllave, në një kanal, ose i përcjellë siç duhet nëpër zonën intersticiale për NFPA 70: kodet NEC- për të cilin ka kërkuar- specifikimi i mësipërm është i paqartë nuk specifikohet çfarë është NFPA 70 dhe çfarë janë kodet NEC. Në të kundërt ju lutem që ky specifikim të hiqet.***3.** *Çdo kabëll që kalon nëpër hapësirën e plenumit do të*

vlërësohet në plenum sipas NEC dhe kodet e zbatueshme të zjarrit ose ekuivalente- për të cilin ka kërkuar- Të specifikoni çfarë është “plenumi” dhe NEC. Në të kundërt ky specifikim të hiqet. **4. Konfiguruar për të parë pacientët në të gjithë spitalin ose zonat e kujdesit- për të cilin ka kërkuar- Duhet specifikuar numri total i monitoreve të pacientit në të gjithë spitalin, modelet dhe prodhuesit perkates, protokollet e komunikimit, vendodhja dhe shtrirja hapsinore. Nje sistem monitorimi qendror duhet të percaktohet se sa monitore pacienti duhet të përfshijë në konfigurim si dhe duhet të percaktohet të pakten perafersisht sipërfaqja e ambienti ku do të instalohet rrjeti për të kryer të pakten llogaritjet të peraferta të kostos së instalimit.****5. Ndërfaqja HL7** Kontraktuesi do të sigurojë një ndërfaqe HL7 për PPMTS-në që lejon shkëmbimin e të dhëna nga pajisjet e kujdesit përmes mesazheve HL7. Te siguroje Sistemi i informacioni, regjistrim të të dhenave- për të cilin ka kërkuar- Të specifikoni çfarë është PPMTS, në të kundërt ky specifikim të hiqet.

Në kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor rezulton se specifikimet në lidhje me:

Artikulli nr.1- sistem monitorimi pacienti me telemetri janë pranuar si vijon:

1. PPMTS do të përfshijë një metodë për të mbledhur, vlerësuar dhe menaxhuar klinikën e rasteve të alarmit në përputhje me Qëllimin Kombëtar të Sigurisë së Pacientit NPSG.06.01.01 për të cilin ka kërkuar- Të specifikoni çfarë është PPTMS dhe NPSG.06.01.01. Në të kundërt të hiqet sepse krijon paqartësi për operatorët ekonomik

Argumentimi i AK

Sistem i monitorimit fiziologjik të pacientit dhe telemetrisë – Patient Physiological Monitoring and Telemetry System (PPMTS)

Synimi Kombëtar i Sigurisë së Pacientit- national Patient Safety Goal NPSG.06.01.01 Lloj standarti ndërkombëtar në lidhje me sistemet e alarmeve klinik të pacienteve.

*2. Numri i pacientëve të shfaqur në stacionin qendror do të jetë njësi specifike me deri në 16 pamje të njëkohshme në ekranin e vetëm - **për të cilin ka kërkuar modifikimin e tij në- Numri i pacientëve (monitorëve të pacientit) të shfaqur në stacionin qendror do të jetë deri në 16 pamje (paciente) të njëkohshme.***

Argumentimi i AK

.....

Bëhet

Numri i pacientëve (monitorëve të pacientit) të shfaqur në stacionin qendror do të jetë deri në 16 pamje (paciente) të njëkohshme.

Artikulli nr.2-Monitori pranë shtratit Lloji A: Monitorët e dhomës operative janë pranuar specifikimet si vijon:

1. Moduli SpO2 - i pajtueshëm me teknologjinë Nellcor Oximax- për të cilin ka kërkuar- Moduli SpO2 - i pajtueshëm me teknologjinë Nellcor Oximax ose teknologji ekuivalente;

Argumentimi i AK

.....

Bëhet

Moduli SpO2 - i pajtueshëm me teknologjinë Nellcor Oximax ose teknologji ekuivalente.

2. Moduli i indeksit bi-spektral (BIS)- për të cilin ka kërkuar modifikimin e tij në- *Moduli i indeksit bi-spektral (BIS) ose ekuivalente.*

Argumentimi i AK

.....

Bëhet

Moduli i indeksit bi-spektral (BIS) ose EEG ose ENTROPY ose teknologji ekuivalente

Artikulli nr.8 Kabllimi/rrjeti

1. Të gjitha linjat e kabllave mbi tavan duhet të mbështillen me kravatë dhe të vendosen në sirtarin e kabllave, në një kanal, ose i përcjellë siç duhet nëpër zonën intersticiale për NFPA 70: kodet NEC- për të cilin ka kërkuar- specifikimi i mësipërm është i paqartë nuk specifikohet çfarë është NFPA 70 dhe çfarë janë kodet NEC. Në të kundërt ky specifikim të hiqet.

Argumentim AK

NFPA 70, Kodi Elektrik Kombëtar (NEC) është pikë referimi për projektimin, instalimin dhe inspektimin e sigurtë elektrik për të mbrojtur njerëzit dhe pronën nga rreziqet elektrike.

2. Çdo kabëll që kalon nëpër hapësirën e plenumit do të vlerësohet në plenum sipas NEC dhe kodet e zbatueshme të zjarrit ose ekuivalente- për të cilin ka kërkuar- Të specifikoni çfarë është “plenumi” dhe NEC. Në të kundërt ky specifikim të hiqet.

Argumentim AK

.....

Bëhet

Çdo kabull do të vlerësohet sipas NEC ose ekuivalent.

5. Ndërfaqja HL7 Kontraktuesi do të sigurojë një ndërfaqe HL7 për PPMTS-në që lejon shkëmbimin e të dhëna nga pajisjet e kujdesit përmes mesazheve HL7. Te siguroje Sistemi i informacioni, regjistrim te te dhenave- për të cilin ka kërkuar- Të specifikoni çfarë është PPMTS, në të kundërt ky specifikim të hiqet.

Argumentim AK

HL&- Protokoll Sigurie për Përpunimin, Ruajtjen dhe Transferimin e të Dhënave të Pacientëve.

Sistem i monitorimit fiziologjik të pacientit dhe telemetrisë – Patient Physiological Monitoring and Telemetry System (PPMTS).

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes për specifikimet teknike të **Artikullit nr.1**- sistem monitorimi pacienti me telemetri : “**1.** Kjo do të jetë për të mbledhur dhe shfaqur parametrat në stacionin qendror dhe për të bërë në dispozicion të EMR. Kjo ndërfaqe të jetë e disponueshme në departamentet 6S, 5W & 5E”. -për të cilin ka kërkuar – Të specifikoni monitorët ekzistues të shenjave vitale. Të specifikoni çfarë është “EMR”, dhe çfarë janë departamentet 6S, 5W & 5E. Në të kundërt ky specifikim të hiqet sepse krijon paqartësi për operatorët ekonomik. **2.** PPMTS do të përfshijë një metodë për të mbledhur, vlerësuar dhe menaxhuar klinikën e rasteve të alarmit në përputhje me Qëllimin Kombëtar të Sigurisë së Pacientit NPSG.06.01.01 - për të cilin ka kërkuar- Të specifikoni çfarë është PPTMS dhe NPSG.06.01.01.Në të kundërt të hiqet sepse krijon paqartësi për operatorët ekonomik; **3.** Pajisja CS duhet të sigurojë tiparet dhe funksionalitetin e mëposhtëm: b Të paktën zgjedhja e përdoruesit 6 parametra për pacient- për të cilin ka kërkuar modifikimin e tij në- Të mundësohet zgjedhja nga përdoruesit për të paktën 4-6 parametra monitorimi për pacient. ; **4.** Numri i pacientëve të shfaqur në stacionin qendror do të jetë njësi specifike me deri në 16 pamje të njëkohshme në ekranin e vetëm - për të cilin ka kërkuar modifikimin e tij në- Numri i pacientëve (monitorëve të pacientit) të shfaqur në stacionin qendror do të jetë deri në 16 pamje (paciente) të njëkohshme.; **5.** Lejoni të gjitha paketat e telemetrisë dhe / ose monitorët e pacientit të lidhur në rrjet fushat e kujdesit që do të shikohen në CS dhe në çdo sistem të klientit CS të rrjetëzuar me CS.

a Në rrjet për të lejuar shikimin e pacientëve në njësi të tjera nga çdo qendër stacioni. - për të cilin ka kërkuar – Të përcaktoni numrin e monitorëve të pacientit që kërkohen të lidhen me sistemin e monitorimit:” **Artikullit nr. 2** Monitori pranë shtratit Lloji A: Monitorët e dhomës operative : “**1.** Moduli SpO2 - i pajtueshëm me teknologjinë Nellcor Oximax- për të cilin ka kërkuar- Moduli SpO2 - i pajtueshëm me teknologjinë Nellcor Oximax ose teknologji ekuivalente; **2.** Moduli i indeksit bi-spektral (BIS)- për të cilin ka kërkuar modifikimin e tij në- Moduli i indeksit bi-spektral (BIS) ose ekuivalente.” - **Artikullin nr.8 Kabllimi/rrjeti :1.** Sistemi Shëndetësor do të sigurojë një lidhje të vetme të rrjetit CAT6a për secilin monitor pranë shtratit dhe stacionit qendror. Kontraktuesi do të sigurojë PPMTS me kërkesat e mëposhtme duke përdorur rrjeti ekzistues kur plotëson specifikimet – për të cilin ka kërkuar- Të përcaktoni për cilat tipe monitorësh (numra artikujsh të lotit) kërkohet që të sigurohet rrejtja për t’u lidhur me stacionin qendror të monitorimit. Specifikoni çfarë është PPMTS dhe çfarë kërkohet konkretisht nga operatorët; **2.** Të gjitha linjat e kabllave mbi tavan duhet të mbështillen me kravatë dhe të vendosen në sirtarin e kabllave, në një kanal, ose i përcjellë siç duhet nëpër zonën intersticiale për NFPA 70: kodet NEC- për të cilin ka kërkuar- specifikimi i mësipërm është i paqartë nuk specifikohet çfarë është NFPA 70 dhe çfarë janë kodet NEC. Në të kundërt ju lutem që ky specifikim të hiqet.**3.** Çdo kabëll që kalon nëpër hapësirën e plenumit do të vlerësohet në plenum sipas NEC dhe kodet e zbatueshme të zjarrit ose ekuivalente- për të cilin ka kërkuar- Të specifikoni çfarë është “plenumi” dhe NEC. Në të kundërt ky specifikim të hiqet. **4.** Konfiguruar për të parë pacientët në të gjithë spitalin ose zonat e

kujdesit- për të cilin ka kërkuar- Duhet specifikuar numri total i monitoreve të pacientit në të gjithë spitalin, modelet dhe prodhuesit perkates, protokollet e komunikimit, vendodhja dhe shtrirja hapsinore. Një sistem monitorimi qendror duhet të percaktohet se sa monitore pacienti duhet të përfshijë në konfigurim si dhe duhet të percaktohet të pakten perafersisht sipërfaqja e ambientit ku do të instalohet rrjeti për të kryer të pakten llogaritjet të peraferta të kostos së instalimit. **5. Ndërfaqja HL7** Kontraktuesi do të sigurojë një ndërfaqe HL7 për PPMTS-në që lejon shkëmbimin e të dhënave nga pajisjet e kujdesit përmes mesazheve HL7. Te sigurojë Sistemi i informacioni, regjistrim të të dhënave- për të cilin ka kërkuar- Të specifikoni çfarë është PPMTS, në të kundërt ky specifikim të hiqet” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Operatori ekonomik ankimes në ankesën e tij ka ankimuar specifikimet teknike si më sipër për të cilat ka kërkuar modifikimin, sqarimin ose heqjen e tyre sipas pikës III.1 të këtij vendimi.

III.1.2. Referuar shkresës drejtuar operatorit ekonomik ankimes si dhe Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2338/13 prot., datë 21.09.2021 nga autoriteti kontraktor, rezulton se janë pranuar vetëm pretendimet në lidhje me specifikimet teknike:

Artikulli nr.1- sistem monitorimi pacienti me telemetri

1. PPMTS do të përfshijë një metodë për të mbledhur, vlerësuar dhe menaxhuar klinikën e rasteve të alarmit në përputhje me Qëllimin Kombëtar të Sigurisë së Pacientit NPSG.06.01.01 për të cilin ka kërkuar- Të specifikoni çfarë është PPTMS dhe NPSG.06.01.01. Në të kundërt të hiqet sepse krijon paqartësi për operatorët ekonomik

Argumentimi i AK

Sistem i monitorimit fiziologjik të pacientit dhe telemetrisë – Patient Physiological Monitoring and Telemetry System (PPMTS)

Synimi Kombëtar i Sigurisë së Pacientit- National Patient Safety Goal NPSG.06.01.01 Lloji standarti ndërkombëtar në lidhje me sistemet e alarmeve klinik të pacienteve.

*2. Numri i pacientëve të shfaqur në stacionin qendror do të jetë njësi specifike me deri në 16 pamje të njëkohshme në ekranin e vetëm - **për të cilin ka kërkuar modifikimin e tij në-** Numri i pacientëve (monitoreve të pacientit) të shfaqur në stacionin qendror do të jetë deri në 16 pamje (paciente) të njëkohshme.*

Argumentimi i AK

.....

Bëhet

Numri i pacientëve (monitoreve të pacientit) të shfaqur në stacionin qendror do të jetë deri në 16 pamje (paciente) të njëkohshme.

Artikulli nr.2-Monitori pranë shtratit Lloji A: Monitorët e dhomës operative janë pranuar specifikimet si vijon:

2. *Moduli SpO2 - i pajtueshëm me teknologjinë Nellcor Oximax- për të cilin ka kërkuar- Moduli SpO2 - i pajtueshëm me teknologjinë Nellcor Oximax ose teknologji ekuivalente;*

Argumentimi i AK

.....

Bëhet

Moduli SpO2 - i pajtueshëm me teknologjinë Nellcor Oximax ose teknologji ekuivalente.

2. *Moduli i indeksit bi-spektral (BIS)- për të cilin ka kërkuar modifikimin e tij në- Moduli i indeksit bi-spektral (BIS) ose ekuivalente.*

Argumentimi i AK

.....

Bëhet

Moduli i indeksit bi-spektral (BIS) ose EEG ose ENTROPY ose teknologji ekuivalente

Artikulli nr.8 Kabllimi/rrjeti

1. *Të gjitha linjat e kabllave mbi tavan duhet të mbështillen me kravatë dhe të vendosen në sirtarin e kabllave, në një kanal, ose i përcjellë siç duhet nëpër zonën intersticiale për NFPA 70: kodet NEC- për të cilin ka kërkuar- specifikimi i mësipërm është i paqartë nuk specifikohet çfarë është NFPA 70 dhe çfarë janë kodet NEC.*

Argumentim AK

NFPA 70, Kodi Elektrik Kombëtar (NEC) është pikë referimi për projektimin, instalimin dhe inspektimin e sigurtë elektrik për të mbrojtur njerëzit dhe pronën nga rreziqet elektrike.

3. *Çdo kabëll që kalon nëpër hapësirën e plenumit do të vlerësohet në plenum sipas NEC dhe kodet e zbatueshme të zjarrit ose ekuivalente- për të cilin ka kërkuar- Të specifikoni çfarë është “plenumi” dhe NEC. Në të kundërt ky specifikim të hiqet.*

Argumentim AK

.....

Bëhet

Çdo kabull do të vlerësohet sipas NEC ose ekuivalent.

5. *Ndërfaqja HL7 Kontraktuesi do të sigurojë një ndërfaqe HL7 për PPMTS-në që lejon shkëmbimin e të dhëna nga pajisjet e kujdesit përmes mesazheve HL7. Te siguroje Sistemi i informacioni, regjistrim te te dhenave- për të cilin ka kërkuar- Të specifikoni çfarë është PPMTS, në të kundërt ky specifikim të hiqet.*

Argumentim AK

HL&- Protokoll Sigurie për Përpunimin, Ruajtjen dhe Transferimin e të Dhënave të Pacientëve.

Sistem i monitorimit fiziologjik të pacientit dhe telemetrisë – Patient Physiological Monitoring and Telemetry System (PPMTS).

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.”*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 *“Për prokurimin Publik”* i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*. Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit me Nr. REF-04480-09-02-2021, Loti 8 me objekt “Sistemi i monitorimit fiziologjik dhe i telemetrisë së pacientit” me fond limit 8,355,926.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 05.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri